

ADMINISTRIMI TATIMOR

PROBLEMET

Deshtimet ne administrimin tatimor

- Progresi ne permiresimin e administrimit te te ardhurave fiskale **ka qene i kufizuar.**
- Te ardhurat tatimore kane pasur trend minimal rritjeje. Barra eshte zhvendosur nga tatimet direkte mbi kapitalin dhe te ardhurat tek ato indirekte mbi konsumin.
- Indikatori me i rendesishem qe tregon efektin e politikave fiskale dhe performancen ne administrim eshte raporti i te ardhurave tatimore me GDP.
- Objektivat ne kete fushe kane qene qe ky tregues te rritej me 0,5 % cdo vit dhe qe ne nje periudhe afatmesme "barra tatimore" te ishte rreth nivelit 28 %, nderkohe qe jemi ne nivelin 23,6 % , ndersa mesatarja e vendeve te BE-se eshte 40 %.
- Por ne 5-6 vitet e fundit, jo vetem nuk jane realizuar rritjet e projektuara, por perkundrazi ne vite te caktuara ka ulje te tij, si psh ne vitin 2009.

Deshtimet ne administrimin tatimor

- Rritja e cmimeve te mallrave dhe sherbimeve per popullaten ka qene evidente dhe e ndjeshme, por qe **nuk eshte shoqeruar me rritjen e te ardhurave nga TVSH-ja**. Kjo pasi evazoni dhe informaliteti vazhdojne te jene ne permasa shqetesuese dhe masive.
- Niveli i importeve dhe zhdoganimeve te cigareve ne vitet 2006-2011 ka ngelur poshte apo i njejte me nivelin e zhdoganimeve te viteve 2003-2005. Per me teper, ne vite te caktuara jane zhdoganuar me pak se ne periudhat paraardhese.
- **Baza e tatimpaguesve nuk pa pesuar zgjerim**. Administrata tatimore ka humbur kontrollin mbi territorin. Bizneset e palicensuar kane lulezuar ne cdo cep.
- Shifrat qe jepen per bizneset e reja te regjistruara mbulojne te dhenat per te njejtin numer biznesesh qe nuk deklarojne apo mbyllin biznesin. Pra rritja reale neto e numurit te bizneseve eshte i paperfillshem.
- Ka dobesi dhe mangesi serioze ne funksionet kyc te administrimit tatimor te tilla si **mosdeklaruesit dhe mospaguesit e detyrimeve tatimore,**

Deshtimet ne administrimin tatimor

- **Ka mungese ne planifikimin strategjik te nevojshem** dhe strukturen per udheheqjen e reformave ne administraten fiskale.
- Administrata fiskale ndodhet ne nje situatë delikate si pasoje e levizjeve dhe **rotacionit permanent te stafit**.
- **Ka mungese strukturash dhe procesesh qe do te siguronin nje udheheqje efektive** mbi nje numur te madh projektesh modernizimi dhe aktivitetesh te drejtimit strategjik.
- **Ndryshimet e ligjeve tatimore kane qene te shumta dhe sfilites per biznesin.** Eshte shume e veshtire per biznesin, per te mos thene e pamundur qe te ndjeke dhe zbatoje ndryshimet e shumta te legjislacionit fiskal te kryera nga kjo mazhorance. Vetem gjate nje periudhe 5 vjecare 2006-2011 ligjet tatimore kane pesuar 45 amendime.

Deshtimet ne administrimin tatimor

- Mungon nje strategji gjithperfshirese e **pajtimit te publikut** me tatimet (tax compliance).
- **Mungojne masat efikase per mbledhjen e tatimeve** dhe komunikimin nepermjet përmirësimit të zbatimeve të teknologjisë së informacionit;
- **Nuk eshte kufizuar ne nivelin e duhur bashkëveprimi dhe liria individuale e veprimit te administrates fiskale me tatimpaguesit;**
- **Nuk eshte zgjeruar baza tatimore** nepermjet përfshirjes ne te te ekonomisë informale;
- **Mungon fushata agresive per edukimin e publikut** në lidhje me përgjegjësitë dhe të drejtat e tatimpaguesit.

Deshtimet ne administrimin tatimor

Problemet me regjistrimin e tatimpaguesve

- Ekziston nje numur shume i madh tatimpaguesish të paqëndrueshëm. 53% e tatimpaguesve të TVSH –se kanë një xhiro nën kufirin ligjor te regjistrimit dhe kontribuojne me me pak se 1% ne të ardhurat nga TVSH-ja.
- Pra këta tatimpagues të vegjël **konsumojnë një sasi jo proporcionale të burimeve** të Administrates Tatimore dhe disiplina e tyre e dobët fiskale mbush listat e mosdeklaruesve dhe mospaguesve.
- **Nuk ka nje strategji te qarte dhe masa paraprake për të parandaluar bizneset mashtruese të dalin si tatimpagues të rinj.**
- **Nuk ka nje program regjistrimi i cili duhet të identifikojë bizneset e paregjistruar.** Nuk bëhet punë sistematike për të identifikuar dhe regjistruar bizneset që operojnë në ekonominë hije.

Deshtimet ne administrimin tatimor

Problemet me dorezimin e deklarave tatimore

- Procedurat për ndjekjen e mosdeklaruesve nuk janë te efektshme.
- **Mosdeklaruesit** janë ne nivelin **25-30 %** për secilin nga tatimet kryesore, cka është e papranueshme. Ky problemi po vazhdon te gerryeje sistemin tatimor shqiptar për një kohë të gjatë
- Regjistri i tatimpaguesve për çdo lloj tatimi është i mbushur me tatimpagues pasive prej shume

Deshtimet ne administrimin tatimor

Problemet me shërbimet e tatimpaguesve

- **Kontaktet me tatimpaguesit po rriten në mënyrë të ndjeshme.** Rritja e vazhdueshme e kontakteve ne zyre bëhet **problematike per shkak te riskut te korrupsionit** si rezultat i kontakteve te drejtperdrejta.
- **Shërbimet qe u ofrohen tatimpaguesve nuk perputhen me risqet më të mëdha të pajtimit.**
- Administrata tatimore nuk e ka aftësinë e shtrirjes në mënyrë proaktive të shërbimeve në ato fusha që përbëjnë riskun më të madh të pajtimit.

Deshtimet ne administrimin tatimor

- **Problemet me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura**
- Megjithese administrate tatimore shqiptare eshte suportuar nga programet e asistences se huaj per te permiresuar mbledhjen e detyrimeve tatimore, **mbledhja e borxhit vazhdon të vuajë nga një sërë dobësissh serioze operationale.**
- **Pamja e borxheve tatimore te papaguara ka qene e zymte,** nderkone qe Qeveria eshte perpjekur ta zgjidhe kete problem **nepermjet amnitive,** cka ka dekurajuar tatimpaguesit e ndershem.
- **Aplikohen praktika jo produktive të vlerësimit tatimor,** cka kontribuojnë në rritjen e tepruar të detyrimeve tatimore të prapambetura. Shumë borxhe tatimore të regjistruara janë të pasakta ose thjesht të pa mbledhshme.
- Administrata tatimore aplikon ne menyre te kunderligjshme dhe te tepruar **vlerësimin alternativ (afrofe).** Vlerësime të tilla janë të tepruara dhe të pafrytshme.

Deshtimet ne administrimin tatimor

Problemet me auditimin tatimor

- Nuk zbatohet plotesisht sistemi i seleksionimit te tatimpaguesve per kontroll **vetem mbi bazen e riskut.**
- **Nuk permiresohen procedurat per rishikimin e perzgjedhjes automatike** te tatimpaguesve per kontroll.
- Shpesh kontrolli tatimor perdoret per te ndeshkuar **“tatimpaguesit opozitare”**
- Risqet e identifikuara te pajtimit , **nuk përdoren** për të drejtuar përpjekjet e auditit për verifikimin

Deshtimet ne administrimin tatimor

- **Problemet me perberjen e Administrates Fiskale**
- Qeveria aktuale **ka zhdukur cdo nocion te merites dhe karrieres** ne Administraten Tatimore.
- **Levizjet e panumurta te stafit** ne periudha kohore shume te shkurtra, largimet nga puna te punonjesve pa suport politik, marrja ne pune e militanteve dhe vendosja ne poste drejtuese e tyre, kane fshire cdo gjurme te nje administrate te sherbimit civil, duke e kthyer ate ne nje arme ne dore te Qeverise per te goditur kundersharet dhe strehe punesimi per militantet dhe tarafin e saj.